




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kačanik
Municipality of Kacanik

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Rr. " Dëshmorët e Lirisë" – Kaçanik
KAÇANIK

Nr.03 – 111/01 – 2028/19
Kaçanik, 21.02 .2019.

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 , Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017. Neni 4 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare , bënë këtë:

SHPALLJE E REKRUTIMIT

I. QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

TITULLI I VENDIT TË PUNËS: MJEK I PERGJITHSHEM 1 (nje pozite) ,
MJEK SPECIALIST I GJINEKOLOGJISE – 1 (nje pozite) , INFERMER/E 3 (tri pozita) dhe MAMI 1 (
nje pozite).

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Koeficienti; për vendin e I të punës: H- 565
Koeficienti për vendin e II të punës: H- 659
Koeficienti per vendin e III te punes H- 377
Koeficienti per vedin e IV te punes H- 471

I. Detyrat dhe përgjegjësitë për Mjek të Përgjithshëm

1. Ofrim i shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe në teren
2. Ofron ndihmë mjekësore për të gjitha sëmundjet në përgjithësi duke u përkujdesur në vazhdimësi për mbrojtjen e shëndetit.
3. Jep këshilla mjekësore rreth mbrojtjes së shëndetit dhe sëmundjeve;
4. Diagnostifikimi i sëmundjes dhe trajtimi i pacientit;
5. Udhëzon dhe trajton në mjekimin parandalues të sëmundjes.
6. Kryen edhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi sa i përket mjekësisë familjare.

Kualifikimi profesional dhe aftësit; Fakulteti i mjekesise se pergjithshme

Certifikata e lincencimit dhe deshmi te tjera te aftesimit.

Te kete shkathtesit te deshmuara dhe efektive te komunikimit me shkrim dhe me goje.

Pervoja e punes eshte e deshirushme.

II. Detyrat dhe përgjegjësit për Mjek specialist të Gjinekologjisë

1. Përkujdesja antenatale për shtatëzanat
2. Kujdesi perinatal dhe posnatal.
3. Kujdesi për planifikim familjar dhe kontracepcion
4. Diagnostifikimi dhe mjekimi i sëmundjeve të traktit riprodhues të femrave.
5. Parandalimi i sëmundjeve të traktit riprodhues të femrave.
6. Parandalimii i sëmundjeve seksualisht transmiseve.
7. Parandalimi i kancerit të gjirit dhe qafes së mitrës.
8. Kujdesi për sëmundje dhe qrrregullime të traktit riprodhues të adoleshentëve dhe grave të moshuara.
9. Intervenimet kirurgjike në traktin riprodhues të shtatëzanave dhe grave tjera.
10. Kryerja e aborteve me indikacione mjekësore dhe lindjeve.

Kualifikimi profesional dhe aftësite; Fakulteti mjekësive-specialiste i gjinekologjise.
Certifikata e licencimit dhe deshmi tjera te aftesimit,
Te kete shkathtesi te deshmuara dhe efektive te komunikimit me shkrim dhe me goj.
Pervoja e punes e deshirueshme.

III. INFERMIER/E

- 1.Ofron kujdesin ndaj pacienteve ne institucionet shendetesore
- 2.Te mbledh te dhena te sakta mbi pacientet.
- 3.Te kryeen te gjitha punet e infermieres qe kerkohen nga shefi i njesise, drejtorit
- 4.Raporton per punen e saj te shefi i njesise dhe kryeinfermieri
- 5.Mban pergjegjesin per mos kryerjen eventuale te detyrave te punes apo per performancen eventualisht te pa mjaftueshme.
- 6.Bashkepunon me anetaret tjer te ekipit mjekesor.etj.

Kualifikimi profesional dhe asftesite;Shkolla e mesme e mjekesise – infermieri e pergjithshme.
Certifikata e licencimit dhe deshmi tjera te aftesimit.
Te kete shkathtesi te deshmuara dhe efektive te komunikimit me shkrim dhe me goje
Pervoja e punes e deshirueshme.

IV.MAMI

- 1.Ofron kujdesin ndaj pacienteve ne institucionet shendetesore
- 2.Te mbledh te dhena te sakta mbi pacientet.
- 3.Te kryeen te gjitha punet e infermieres qe kerkohen nga shefi i njesise, dhe kryeinfermierja /i
- 4.Raporton per punen e saj te shefi i njesise dhe kryeinfermieri/ja
- 5.Mban pergjegjesin per mos kryerjen eventuale te detyrave te punes apo per performancen eventualisht te pa mjaftueshme.
- 6.Bashkepunon me anetaret tjer te ekipit mjekesor.etj.
- 7.Ofron keshilla dhe edukim per pacientet dhe komunitetin lidhur me planifikimin familjar dhe SST.
- 8.Ofron sherbime te kujdesit antenatal dhe raporton per punen e saj te shefi i njesise
- 9.Miremban ambientin e punes

Kualifikimi profesionale dhe aftesite;Shkolla e mesme mjekesise –drejtimi mami

Certifikata e licencimit dhe deshmi tjera te aftesimi

Te kete shkathtesi te deshmuara dhe efektive te komunkimit me shkrim dhe me goje
Pervoja e punes e deshirueshme.

Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe ekzistue.

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas ligjit të punës Nr.03/L-212.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave:

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në objektin e Qendrës Kyresore të Mjekësisë Familjare (QKMF) zyra nr.106, brenda 15 ditë prej ditës së shpalljes së konkursit në shtyp.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

Kopjen e vërtetuar të Diplomës, dëshmi të përvojës së punës, certifikatën shëndetësore, kopjen e letërnjoftimit, licencën e punës, certifikatën e lindjes, dëshminë se nuk është nën hetime .

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE U SHËRBEN TË GJITHË BANORËVE TË KOSOVËS DHE MIRËPRET APLIKACIONET NGA FEMRAT DHE MESHKUJT E TË GJITHA KOMUNITETEVE TË KOSOVËS

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë Drejtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë familjare.

Drejtori i QKMF-së
Dr. Sinan Zeneli
Specialist i mjeks.familjare

